

Konferenca Kombëtare

Pjesëmarrja dhe Përgjegjësia e Shoqërisë Civile në Proçeset e Qeverisjes Vendore

Në datë 22.6.2020, në orën 10:00, [Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim](#) (GADC) në partneritet me anëtarët e [Rrjetit Përballja e Ofertave Politike POP](#), e me mbështetjen e [Qeverisë Suedeze](#) përmes [Olof Palme International Center](#) dhe [National Endowment for Democracy](#) organizuan Konferencën Kombëtare [“Përfshirja dhe angazhimi qytetar në nivel vendor”](#). Ky aktivitet u zhvillua pranë Hotel “Rogner”, ndërkohë që përveç personave prezent kishim edhe pjesëmarrjen e rreth 70 personave online, nga 12 bashki të vendit.

Gjatë kësaj konference u diskutua mbi pjesëmarrjen dhe angazhimin qytetar në nivel vendor, dhe bazuar pikërisht në këtë pikë kaq të rëndësishme u prezantua edhe Raporti Studimor me të njëjtin titull.

Anëtarët e rrjetit POP besojnë se, pjesëmarrja e drejtpërdrejtë ose demokracia me pjesëmarrje, është një nga format e pjesëmarrjes dhe përfshirjes së qytetarëve në jetën publike, e cila ushtrohet përmes mjeteve dhe mekanizmave që institucionet publike në emër dhe zbatim të ligjit, vënë në dispozicion të qytetarëve, me qëllim përfshirjen e tyre në formulimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave, programeve dhe shërbimeve për komunitetin.

Në këtë takim morën pjesë: Znj. Romina Kuko, zv. Ministre e Brendshme që mbulon qeverisjen vendore; Znj. Diamanta Vito, Eksperte për Menaxhimin e Qeverisjes Vendore; Znj. Alketa Lamani, Drejtore Ekzekutive - Qendra Rinore e Vlorës; Z. Blendi Dibra, Drejtor Ekzekutiv – Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër; Z. Saimir Plaku, Drejtor i Përgjithshëm – Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore; Znj. Elona Hoxhaj, Drejtore e Drejtorisë së Vlerësimit të Ankesave në Drejtorinë e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit; Dr. Valbona Karakaçi, “Bashki të Forta”; Z. Erton Kashta, Drejtor Ekzekutiv, “Lëviz Albania”; Znj. Jolanda Trebicka, nga “Bashki për në Evropë”; Znj. Silvana Malaj nga Projekti “Star”; Znj. Aulona Veizi, Nënkryetare – Bashkia Vlorë; Znj. Anisa Subashi, Drejtoreshë e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale – Bashkia Tiranë; Z. Artan Gashi, Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit Social – Bashkia Elbasan; Znj. Miriam Reçi, Drejtore Ekzekutive - CSDC Durrës; Znj. Nevila Jahaj, Drejtore Ekzekutive – “Epoka e Re”; Znj. Mirela Arqimandriti “GADC”, Tiranë; Znj. Esmeralda Hoxha – Koordinatore e Rrjetit POP.

Pas fjalës përshëndetëse nga **znj. Mirela Arqimandriti** dhe **znj. Miriam Reçi**, mbi rëndësinë e punës së bërë deri më tani, fjala iu dha **znj. Romina Kuko**, zv. Ministre e Brendshme, e cila theksoi situatën e ndryshuar në krahasim me disa vite më parë, kur bashkitë dhe qytetarët nuk koordinonin mes tyre. Ndër të tjera znj. Kuko shtoi: *“Ndërlidhja mes zërit të qytetarëve dhe pushtetit vendor së pari dhe më pas edhe në nivele më të larta, është jashtëzakonisht mjaft e rëndësishme. Sepse qytetarët janë opozita më e mirë përse i përket mirëqeverisjes. Ndaj, të gjithë duhet ta kuptojmë aktivitetin e sotëm si një aktivitet mjaft të rëndësishëm, si një takim përmes të cilit arrijmë të gjejmë disa të vërteta. Brenda pak vitesh, ne kemi një arkitekturë të plotë për të patur jo vetëm një pushtet vendor në administrim të territorit por patjetër për shërbime dhe konsultim të qytetarëve. Sa i përket hallkës kryesore, përveç ndërveprimit të drejtpërdrejtë që doja ta apeloja sot edhe nëpërmjet “Rrjetit POP”, por edhe nëpërmjet të gjitha bashkive, duhet të ketë takime të vazhdueshme nga grupe interesi apo organizata të shoqërisë civile me bashkitë për çështje të caktuara. Këto takime janë shumë të rëndësishme, praktika që quhen “Town Hall meetings”*

dhe janë të domosdoshme për të rikalibruar politikat dhe për të parë interesat e qytetarëve se ku qëndrojnë ato.”

Ndërkohë që **znj. Diamanta Vito**, prezantoi raportin studimor: *“Pjesëmarrja dhe Përgjegjësia e Shoqërisë Civile në Proçeset e Qeverisjes Vendore”* dhe ndau gjetjet e raportit, ku theksoi nevojën për angazhim pro-aktiv të qytetarëve si dhe konsulta afatgjata me publikun për të rritur besimin dhe përfshirjen. Ajo gjithashtu theksoi se, formulari i konsultimit duhet të jetë i detyrueshëm në krahasim me tani.

Për të lexuar raportin e plotë ju lutemi të klikoni [këtu](#).

Anëtarët e “Rrjetit POP” bënë disa ndërhyrje përsa i përket përfshirjes qytetare dhe angazhimit qytetar në nivel vendor. **Z.Blendi Dibra** informoi se, organizata që ai drejton u përqëndrua në monitorimin e kriterëve ligjore për t'u zbatuar nga Bashkia e Shkodrës. Në lidhje me të drejtën për informim, z. Dibra deklaroi se: *“Bashkia e Shkodrës plotëson vetëm 3 nga 28 kriteret e kërkuara, prandaj ata bashkëpunuan me Komisionerin për të Drejtën e Diskriminimit për të përmirësuar këtë çështje.”* Ai theksoi rëndësinë e informacionit cilësor për qytetarët në mënyrë që, proçesi i konsultimit të jetë sa më efektiv dhe punën monitoruese që “Intelektualët e Rinj Shpresë” bëjnë si anëtarë të “Rrjetit POP”.

Ky raport u diskutua edhe nga **znj. Alketa Lamani**, e cila ndër të tjera theksoi nevojën e përfshirjes qytetare dhe angazhimit të tyre qoftë në nivel lokal por edhe në atë qendror. Ndër të tjera znj. Lamani shtoi: *“Qendra Rinore e Vlorës po punon për një udhëzues për bashkitë në lidhje me konsultimet dhe mendoj se, organizatat e shoqërisë civile dhe projektet që aplikohen për angazhimin e qytetarëve janë mjaft të rëndësishme.”*

Ndërsa, sa i përket projekteve në nivel vendor, **znj. Valbona Karakaçi** theksoi faktin e rëndësisë së kësaj teme mjaft të ndjeshme me defiçite jo aq ligjore sesa kulturore. „Bashki të Forta“ ka konstatuar nga kuadri ligjor se, kur flitet për përgjegjësinë e bashkisë, termi „Bashki“ për shumë kohë ka parakuptuar ekzekutivin. Në mendësinë e institucioneve, interpretim i ligjit është bashkia e barabartë me ekzekutivin dhe ky fakt lë jashtë Këshillin Bashkiak. Znj. Karakaçi informoi se „Bashki të Forta“, në këtë periudhë është përpjekur që të bëjë ribalancimin e definicionit duke i dhënë këshillit atë që i takon, duke qenë se demokracia përfaqësuese e zgjedhur e detyron këshillin ta ushtrojë këtë rol në koordinim me ekzekutivin. Ndër të tjera znj. Karakaçi tha: *„Bashkitë e vendit/Këshillat janë të pajisur me regjistrin elektronik për konsultimet me publikun, me regjistër për peticione, ankesa, kërkesa dhe formate online për t'i adresuar këto problematika. Problemi që „Komisioneri për të Drejtën e Informimit“ dhe të gjithë së bashku duhet të diskutojmë është, nëse këto instrumenta që dokumentojnë pjesëmarrjen e qytetarëve i kanë të rregulluara marrëdhëniet mes këshillit dhe ekzekutivit në këtë proçes. Gjithashtu, pandemia na mësoi të përdorim teknologjinë dhe avantazhet e saj si: kosto më të ulëta, shpejtësi në kohë reale dhe të dhëna transparente në kohë reale. Ndaj ne po aplikojmë pyetsorë online që lejojnë në kohë reale të shikosh kënaqësinë e qytetarit dhe po njësoj pyetsorë online edhe për buxhetin.”*

Z. Saimir Plaku solli në vëmendje që “Agjensia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore”, me reformën administrative territoriale parashikon transparencën, konsultimin dhe pjesëmarrjen sipas ligjit 139/2015. Gjithashtu, përveç Ligjit të Vetëqeverisjes Vendore, qeveria shqiptare me politikbërjen e saj ka të parashikuar edhe planin e veprimit në zbatim të dokumentit strategjik 2020-2022, i cili ka për qëllim decentralizmin dhe reformën e qeverisjes vendore mbi forcimin e qeverisjes së mirë në nivel vendor, ku një rëndësi e madhe i jepet angazhimit qytetar me komisione rinore, qytetare, kryetarët e fshatrave, ndërlihdësit qytetarë etj.

“Të gjitha sa më sipër, ndikojnë drejtëpërdrejtë mbi pjesëmarrjen dhe angazhimin qytetar në nivel vendor dhe të gjitha VQV-të e kanë synim pjesëmarrjen dhe angazhimin e qytetarëve në vendimarrje. Aktualisht, jemi përpara faktit që informimi i qytetarëve arrihet më tepër në formën klasike, por pjesa tjetër nëpërmjet rrjeteve sociale apo/dhe faqeve të internetit mbetet akoma e ulët. Angazhimi i transformuar i politikave qeveritare demokratike dhe pjesëmarrja e qytetarëve, janë një prioritet thelbësor i BE-së, ndaj kërkohet një vëmendje e veçantë dhe përkrahje për të vendosur mekanizma funksionalë të pjesëmarrjes në vendimarrje të qytetarëve, me qëllim rritjen e besimit të tyre për të bërë të mundur angazhimin në jetën aktive të qeverisjes vendore.” – shtoi z. Plaku.

Nga zyra e “Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale”, **znj. Elona Hoxhaj** theksoi rëndësinë dhe kontributin që takime të kësaj natyre sjellin, duke i konsideruar organizatat e shoqërisë civile si partnere jo vetëm për ecurinë e punës së zyrës së Komisionerit, por edhe për rritjen e transparencës dhe përgjegjshmërisë së autoriteteve publike në lidhje me llogaridhënien dhe pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në proceset vendimarrëse. Ndër të tjera znj. Hoxhaj shtoi : *“Nga puna në vazhdueshmëri e Komisionerit, ne konstatojmë një problematikë shumë të madhe përsa i përket mosnjohjes së zyrës së Komisionerit, gjithashtu mos njohje më tej edhe të Ligjit për të Drejtën e Informimit, i cili është një nga ligjet më të mirë në rang botëror dhe duhet vetëm të aplikohet dhe të njihet nga të gjithë ne, në mënyrë që të gjejë zbatim ashtu sikundër duhet. Duhet cituar dhe theksuar se, Programi i Transparencës është një instrument të cilin ligji për të drejtën e informimit e ka vënë në dispozicion të qytetarëve, që ata të realizojnë në mënyrë proaktive të drejtën e tyre për informim. Ky program është i detyrueshëm për t’u publikuar në faqen zyrtare të të gjitha bashkive, por nga monitorimi që kemi bërë ka problematika pikërisht me elementin kryesor, mos pasjen e një faqe në web-in e bashkisë, dhe për këtë mungesë shumë prej tyre janë sanksionuar dhe të dhënat janë publikuar nga zyra jonë në raporte të ndryshme, përfshirë edhe raportin vjetor.”*

Z. Erton Kashta theksoi rëndësinë që ka informimi i qytetarëve si hapi i parë, duke qenë se, në shumicën e rasteve informacioni që ata marrin është shumë teknik. Gjithashtu, edhe dëshira e tyre për të qenë aktiv dhe qasja që organizatat e shoqërisë civile duhet të kenë për t’ju afruar qytetarëve dhe për t’i angazhuar ata në çështje konkrete. Ndër të tjera z. Kashta shtoi: *“Përsa kohë gjendemi përballë bashkive që nuk kanë burime të mjaftueshme për të realizuar elementët që janë të përcaktuar dhe të detyrueshëm me ligj dhe nga ana tjetër kemi qytetarë që do të donin të ishin shumë aktiv por në fakt nuk janë, zgjidhja e vetme mbetet një ndërfaqje si kjo e sotmja. Qasja e “Lëviz Albania” është pikërisht mbështetja e organizatave të shoqërisë civile që shërbejnë si ndërmjetës midis qytetarëve dhe organeve të qeverisjes vendore. Dhe nga ana tjetër të mbështesë qytetarët ose grupet e qytetarëve që të jenë aktivë dhe të kërkojnë më shumë transparencë dhe llogaridhënie nga qeverisja vendore. Ka patur një trend në rritje të përdorimit të peticioneve si mjet komunikimi me qeverinë vendore dhe “Lëviz Albania” ka qenë një forcë ndikuese në rritjen e përdorimit të këtij mekanizmi, megjithatë shtoi z. Kashta – theksi nuk duhet vendosur te forma e peticionit, por tek adresimi i problematikës që ai paraqet. Nuk është arritje të bësh një peticion, arritje është të vazhdojë të bësh presion ndaj qeverisjes vendore derisa të marrësh një përgjigje.”*

Znj. Silvana Malaj e vlerësoi si mjaft të rëndësishme këtë nismë dhe raportin informativ edhe për projektin “STAR”, që kontribuon në përmirësimin e qeverisjes vendore dhe në përmirësimin e konsultimit dhe transparencës. Në fazën e tij të dytë, që ka përfunduar në mars të vitit 2020, projekti ka prekur dhe ka vënë disa gurë të rëndësishëm themeli për zbatimin e kuadrit ligjor për transparencën dhe konsultimin publik. Ndër të tjera znj. Malaj tha: *“Janë zhvilluar disa instrumenta operacionalë për të lehtësuar punën e bashkive për konsultimin publik dhe për organizimin e tij për futjen e standardeve në proceset e punës,*

për të siguruar qeverisjen vendore me pjesëmarrje, duke përfshirë këtu rritjen e kapaciteteve në nivel vendor. Dua të theksoj këtu programin e transparencës, si një gur themeli i rëndësishëm i cili është një program i dedikuar për qeverisjen dhe i aprovuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit, si detyrim ligjor për bashkitë. Është një program mjaft i rëndësishëm dhe ezaurues në bazë të të cilit projekti “Star” ngriti një faqe standarte të bashkive, duke pajisur edhe 13 bashkitë që nuk kishin faqe me këtë standart. Dua të përmend që, sot kemi të publikuara vendimet e këshillave bashkiakë në një platformë kombëtare, ku të gjitha bashkitë publikojnë vendimet e tyre. Këto instrumente jo vetëm lehtësojnë punën e administratave vendore, por gjithashtu janë ndihmë edhe për shoqërinë civile me qëllim monitorimi.”

Znj. Jolanda Trebicka, ish drejtuese e projektit “Bashkitë për në Evropë”, bëri një prezantim për Njësitë e Integritimit Evropian, rolin dhe funksionet e tyre. Ajo ndaloi në përfitimet nga asistenca e BE-së, por edhe plotësimin e detyrimeve që vendos përpara agjenda e integritimit në BE. Që prej datës 1 maj 2005, kushdo që kërkon informacion për BE-në, mund të drejtohet pranë “Rrjetit të Informacionit në nivelin lokal Europa Direkte”. Rrjeti i informacionit ka për qëllim t’i ofrojë publikut fakte dhe shifra për çështje të BE-së, përkatësisht në zonat urbane dhe rurale. Ndër të tjera znj. Trebicka prezantoi edhe Studimin “Legjislacioni i Bashkimit Evropian dhe Qeverisja Lokale në Shqipëri” (2019), i cili identifikoi se: 70% e legjislacionit ndikon në kompetencat & standartet e QV; 50 % e legjislacionit ndikon në mënyrën e funksionimit të QV. Nga 33 kapitujt e Acqui Communautaire - Legjislacionit të BE, në 23 prej tyre ka një përfshirje të drejtpërdrejtë të bashkive në zbatimin e legjislacionit. Vlerësimi ka filluar në vitin 2017 dhe do të zgjasë gjatë gjithë procesit të anëtarësimit të vendit në BE, deri në përmbylljen e negociatave. “Unë ju ftoj të vizitoni të dhënat që bashkitë raportojnë, sepse roli juaj është mjaft i rëndësishëm si për të pranuar çfarë bashkitë raportojnë, si edhe për të sfiduar atë çfarë ato raportojnë. Ju ftoj ta përdorni, sepse në këtë mënyrë përmirësohet demokracia por edhe rritet niveli i përgjegjshmërisë.” – e mbylli fjalën e saj znj. Trebicka.

Për përfshirjen qytetare në perspektivën e qeverisë vendore:

Znj. Aulona Veizi, duke qenë pjesë e diskutimit përgjatë konferencës, e mbylli fjalën e saj duke thënë: “Studimi në vetvete, analiza dhe metodologjia janë shumë të mira dhe ky dokument do të ndihmojë bashkinë në përmirësimin e punës së saj. Mendoj se është shumë i rëndësishëm ky takim, sepse këtu lindin shumë nevoja dhe duhet edhe përfshirja e shumë aktorëve për të ndihmuar. Bashkitë po riformatohen dhe kanë nevojë për mbështetje jo vetëm me aktorë por edhe me format e studimit. Nëse në raporte të ndryshme pasqyrohet se si është gjendja e bashkisë, mendoj se duhen edhe alternativa të zgjidhjes së problemeve.”

Znj. Anisa Subashi vlerësoi Kontratën Sociale me bashkinë Tiranë, si dhe raportet dhe studimet në vazhdimësi dhe kërkoi ndër të tjera ndarjen dhe komunikimin e këtyre gjetjeve me drejtoritë e komunikimit me qytetarët. Ndër të tjera, znj. Subashi shtoi: “Çdo nismë apo projekt që realizohet, delegohet te këto drejtori dhe çdo informacion vendoset në stendat e bashkisë ose në rrjetet sociale, në mënyrë që të gjithë qytetarët të marrin shërbimin dhe të informohen për çdo nismë që ndërmerr bashkia e Tiranës. Gjithashtu një mjet mjaft i rëndësishëm që ka dhënë rezultat është edhe numri i gjelbër 08000888 apo edhe kutia postare e kryetarit të kësaj bashkie.”

Z. Artan Gashi u shpreh se, “Buxheti me Pjesëmarrje” është një eksperiencë e mirë e bashkisë Elbasan që nga viti 2005 e në vijim. Lidhur me këtë fakt dhe me shtrirjen që ka bashkia, ata i kanë kushtuar një rëndësi të madhe qytetarëve, dhe ky proces është realizuar çdo vit, por për shkak të pandemisë u ndërpre. “Në vitin 2020 u realizua në format hibrid me qytetarët, ku ata adresuan problematikat e tyre të cilat do të merren parasysh nga bashkia e Elbasanit në hartimin e buxhetit për vitin që vjen.”

Është e nevojshme mbështetja nga organizatat, qofshin ato kombëtare apo edhe ndërkombëtare, për të rritur akoma më shumë nivelin aktual të ndihmës për qytetarët për përfshirjen dhe angazhimin e tyre me pushtetin vendor.” – e përmbylli fjalën e tij z. Gashi.

Në mbyllje të aktivitetit **znj. Mirela Arqimandriti** theksoi se, do të ketë bisedime dhe hapa të mëtejshëm nga “Rrjeti POP” për të vazhduar punën. Raporti do të prezantohet nga organizatat lokale anëtare të rrjetit, në bashkitë nga kanë dalë edhe gjetjet. Gjithashtu, znj. Arqimandriti i bëri thirrje të gjithë aktorëve për të bashkëpunuar në përmirësimin dhe nxitjen e rolit të qytetarëve për të qenë më të përfshirë dhe aktivë në procesin vendimmarrës dhe rritjen e transparencës dhe llogaridhënies.

**Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga “Olof Palme International Center” dhe “National Endowment for Democracy.” Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:*

- Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, Tiranë;
- Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;
- Qendra Rinore Vlorë,
- Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz;
- Epoka e Re, Fier;
- Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër;
- Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;
- Qendra Rinore për Progres, Kukës,
- Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Progradec.
- Gruaja në Zhvillim, Korçë
- Tjetër Vizion, Elbasan
- Hapa të Lehtë, Vau i Dejës

Për detaje të tjera rreth Rrjetit POP (Përballja e Ofertave Politike), kontaktoni:

Esmeralda Hoxha, Koordinatorë e rrjetit POP

Tel: +355 (0) 69 61 20 169

E-mail: perballjaeofertavepolitike@gmail.com